



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 664/4 Prot.

Tiranë, më 30.09.2021

V E N D I M

Nr.120, datë 30.09.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 222, datë 26.05.2021, për lirim nga shërbimi civil në shërbimin e jashtëm, të nëpunësit **, për shkak të mos pajisjes me certifikatën e DSIK, si dhe mos transferimit të tij në një pozicione tjetër të shërbimit civil dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.***

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 664 prot., datë 10.06.2021, nëpunësi civil në periudhë prove i Shërbimit të Jashtëm ***** , ka ngritur pretendime për veprime e mosveprime të parregullta të kryera nga njësia përgjegjëse dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), në lidhje me lirim nga shërbimi civil, për shkak të mospajisjes me certifikatën e DSIK dhe mos transferimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për të cilin ai plotëson kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës.

Duke marrë indicje nga kjo kërkesë, bazuar në nenin 16, Kreut III, “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u administrua gjithë dokumentacioni shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit, dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. 664/2 prot., datë 12.07.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ, “*Kthim përgjigje*”, si dhe dokumentacioni i administruar nëpërmjet komunikimit elektronik nga subjektet përkatëse.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të mësipërme në kuadër të hetimit administrativ, rezulton se: Kërkuesi *****, në përfundim të procedurës së konkurrimit është shpallur kandidat fitues dhe mbi këtë bazë, me aktin nr. 3410 prot, datë 03.08.2020, të DAP, “*Emërim*”, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Nismave Rajonale, në Drejtorinë e Rajonit dhe Vendeve Fqinje, në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve Politike dhe Strategjike, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 23/2015, “*Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë*”, pozicioni i mësipërm përshihet në skemën e Shërbimit të Jashtëm dhe gëzon statusin e diplomatit të karrierës.

Në Kreun IV, Seksioni II, të vendimit nr. 816, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë*”, përcaktohet se, nëpunësi i përzgjedhur nga DAP-i, që emërohet për herë të parë në Shërbimin e Jashtëm, përveç detyrimeve të parashikuara për ndjekjen e ciklit të detyrueshëm pranë ASPA, i nënshtrohet gjatë periudhës së provës, edhe një procedure trajnimi dhe testimi pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Nga sa më sipër, sipas informacionit të dërguar nga Ministria, rezulton se kërkuesi *****, gjatë periudhës së provës, i është nënshtuar njëkohësisht trajnimit të vazhdueshëm pranë Akademisë Diplomatike, për statusin e diplomatit dhe trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA, gjatë periudhës 2-17 mars, 2021, në përfundim të së cilës është pajisur me certifikatën përkatëse, nga ku rezulton të jetë vlerësuar me 27 pikë.

Më tej, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 23/2015, “*Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë*”, rezulton se për nëpunësin ***** ka vijuar procedura për verifikimin e pastërtisë së figurës nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe rezulton se është refuzuar lëshimi i certifikatës së sigurisë.

Pas marrjes dijeni për refuzimin e dhënies së certifikatës së sigurisë, me shkresën nr. 5376 prot., datë 05.05.2021, Sekretari i Përgjithshëm i MEPJ, “*Kërkesë për interpretim*”, ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, udhëzim në lidhje me hapat që duhen

ndërmarrë nga ana e Ministrisë ndaj nëpunësve civilë në periudhë prove, për të cilët nuk është lëshuar certifikata e sigurisë nga DSIK.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 2890/1 prot., datë 17.05.2021, duke interpretuar dispozitat e Kreut IX, të vendimit nr. 816, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, ka argumentuar se, mospajisja me certifikatën e sigurisë, përbën shkak për përjashtimin nga Shërbimi i Jashtëm edhe për nëpunësit civilë në periudhë prove, të cilët janë kandidatë për t’u rekrutuar në këtë shërbim.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr. 222, datë 26.05.2021, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të MEPJ, “Për lirim nga detyra”, është vendosur lirimi nga detyra i nëpunësit civil në periudhë prove ***** , si dhe ndërprerja e marrëdhënies financiare në datën 31.05.2021.

Rezulton se, kërkuesi ***** , nëpërmjet komunikimit elektronik, me email-in e të datës 01.06.2021, i është drejtuar Sektorit të Ankesave Administrative dhe Përfaqësimit Gjyqësor, duke kërkuar njohjen me vendimin e DSIK për refuzimin e dhënies së certifikatës së sigurisë, si dhe informacion nëse titullari i MPEJ ka kërkuar pranë DSIK rishqyrtim të vendimit për refuzimin e certifikatës së sigurisë.

Nëpërmjet email-it të datës 18.06.2021, nëpunësi është informuar se, nuk mund të pajisjet me vendimin e refuzimit të certifikatës së sigurisë, pasi ky akt duhet të kërkohej pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, si organi kompetent që e ka prodhuar këtë dokument. Në të njëjtën kohë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar nëpunësin, se titullari i institucionit nuk ka kërkuar rishikimin e vendimmarrjes së DSIK, kështu që ai vendim konsiderohet i formës së prerë.

Njëkohësisht, rezulton se nëpunësi ***** , me shkresën nr. 6622 prot., datë 01.06.2021, ka ankimuar vendimin nr. 222, datë 26.05.2021, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të MEPJ, “Për lirim nga detyra”, tek Sekretari i Përgjithshëm, duke pretenduar se ky akt vjen në kundërshtim me dispozitat e nenit 36, të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, ku pajisja me certifikatë sigurie nuk përbën kriter për pranimin në Shërbimin e Jashtëm.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga ky nëpunës, rezulton se, Sekretari i Përgjithshëm i MEPJ, me shkresën nr. 6622/1 prot., datë 17.06.2021, “Kthim përgjigje”, ka argumentuar se, vendimi i njësisë së burimeve njerëzore për lirim nga detyra është marrë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, i cili detyron organin publik (*ministrinë*),

që në rast të mospajisjes me certifikatë sigurie të nëpunësit, ta përjashtojë atë nga ushtrimi i detyrave në shërbimin e jashtëm.

Në kushtet e mësipërme, nëpunësi ***** ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, jo vetëm për konstatimin e paligjshmërisë së aktit për lirimin nga shërbimi i jashtëm, por edhe për transferimin ose sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil, duke pretenduar se gëzon të drejta, në cilësinë e nëpunësit civil.

Në analizë të rrethanave të mësipërme dhe të dokumentacionit të administruar, Komisioneri çmon se nuk duhet të shprehet në lidhje me kërkimin e parë të nëpunësit ***** , për paligjshmëri të vendimit 222, datë 26.05.2021, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të MEPJ, *“Për lirim nga detyra”*, në kushtet kur rezulton se ky akt administrativ është duke u shqyrtuar prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të kërkesëpadisë së depozituar nga nëpunësi në fjalë, (me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 222, datë 26.05.2021, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e jashtme për “Lirim nga detyra”, të palës paditëse. Detyrimin e palës së paditur Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme që të rikthejë paditësin në shërbimin e jashtëm , pagimin e pagës, etj.*).

Nisur nga nga përmbajtja e nenit 36, paragrafi II dhe III, të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se asnjë institucion nuk mund të trajtojë çështje të cilat janë trajtuar ose janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor, si dhe nga mundësia që i njeh nëpunësit civil, neni 41, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për t’u ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative të mundshme, Komisioneri ka vlerësuar që, ky kërkim duhet të arkivohet.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e dytë se, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe njësia përgjegjëse (DAP), duhet të kishin sistemuar/transferuar këtë punonjës në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për të cilin nuk kërkohet pajisja me certifikatën e sigurisë së DSIK, me arsyetimin se, mospërfitimi i statusit të diplomatit nuk kushtëzon përfitimin e statusit të nëpunësit civil, Komisioneri vëren se, në rastin konkret, mosmarrëveshja administrative objekt shqyrtimi lidhet me marrëdhënien juridike të shërbimit civil në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilës zbatohen veçanërisht dispozitat ligjore vijuese, si më poshtë:

Ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, përbëjnë kuadrin ligjor, i cili rregullon marrëdhënien e shërbimit civil dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm dhe profesional. Pavarësisht se fusha e veprimit të këtij kuadri ligjor shtrihet ndaj çdo nëpunësi civil, në përmbajtje të dispozitave të këtij ligji parashikohen raste

përfashtimore, ku elementë të ndryshëm të marrëdhënies në shërbimin civil të rregullohen nga një ligj i posaçëm.

Konkretisht, në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet se punonjësit e shërbimit të jashtëm janë nëpunës civilë dhe ndaj tyre zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm. Në pikën 2 dhe 3, të nenit 3, të po këtij ligji, përcaktohet qartësisht se ligji për shërbimin civil përjashton nga fusha e veprimit të tij disa elementë të marrëdhënies së shërbimit civil në shërbimin e jashtëm, të tilla si kushte shtesë për rekrutimin, të drejta ose detyrime specifike të ndryshme nga ato të parashikuara nga ky ligj, rregulla të posaçme për zhvillimin e karrierës, etj.

Dispozitat e mësipërme ligjore, e referojnë zgjidhjen e rastit të nëpunësit ***** në ligjin nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, i cili përbën ligjin e posaçëm për rregullimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm, të cilat lidhen veçanërisht me kriteret e pranimit në këtë shërbim, me statusin e diplomatit dhe sistemin e karrierës diplomatike.

Në përmbajtje të dispozitave të ligjit të posaçëm për shërbimin e jashtëm, vërehet se rregullat e shërbimit civil gjejnë zbatim të plotë në rastin e emërimit për herë të parë në shërbimin e jashtëm, ku në nenin 36, të tij parashikohet se, pranimi bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil dhe këtë ligj, procedurë e cila në kuptim të Seksionit 1 dhe 2, të vendimit nr. 816, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, zhvillohet nga Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Në vijim të këtij arsyetimi, vërehet se, zhvillimi i karrierës diplomatike, konkretisht periudha e provës së nëpunësit civil në shërbimin e jashtëm, përfitimi ose mospërfitimi i statusit të diplomatit, procedura për përfitimin e gradave diplomatike, emërimi në përfaqësi diplomatike apo poste konsullore, humbja e statusit të diplomatit apo përjashtimi nga Shërbimi i Jashtëm, janë institute të cilat nuk gjejnë rregullim në legjislacionin e shërbimit civil, por rregullohen nga ligji nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe rregullorja përkatëse, dalë në bazë e për zbatim të tij.

Konkretisht, në nenin 36, të ligjit të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, nëpunësi civil i përzgjedhur nga DAP, që pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, emërohet për herë të parë në një pozicion pune në Shërbimin e Jashtëm, i nënshtrohet periudhës së provës.

Lidhur me detyrimet që duhet të përmbushë nëpunësi civil gjatë periudhës së provës në Shërbimin e Jashtëm, rregullimet e përgjithshme ligjore e nënligjore të zbatueshme për të gjithë nëpunësit civilë, gjejnë zbatim për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në nenin 36, të ligjit nr. 23/2015, *“Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”* dhe në Seksionin II, Kreu IV, të vendimit nr. 816, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”*.

Në përmbajtje të dispozitave të mësipërme, përcaktohet se, kandidatët, gjatë periudhës së provës, përveç vlerësimit të rezultateve individuale në punë, i cili bëhet nga eprori direkt dhe kryerjes së ciklit të detyrueshëm të trajnimit, sipas përcaktimit të ligjit për nëpunësit civil (trajnimin e detyrueshëm në ASPA), i nënshtrohet njëkohësisht procedurës së trajnimit të detyrueshëm pranë strukturave të ministrisë, si dhe vlerësimit etiko-profesional që kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike.

Në përfundim të periudhës së provës, vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike, vlerësimi i eprorit direkt dhe vlerësimi i strukturave trajnuese në MEPJ, përcillen nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, tek ministri, i cili shprehet me vendim për pranimin ose mospranimin e nëpunësit në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe në strukturën e Shërbimit të Jashtëm ku ai punësohet.

Nga sa më sipër, në kushtet kur legjislacioni i posaçëm ka përcaktuar në mënyrë të qartë detyrimet që nëpunësi civil i shërbimit të jashtëm duhet të përmbushë në mënyrë kumulative gjatë periudhës së provës, vlerësohet se, përfitimi i statusit të nëpunësit civil dhe përfitimi i statusit të diplomatit nuk qëndrojnë të ndara, ashtu siç pretendon kërkuesi *****. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një marrëdhënie të vetme juridike, që përmban kërkesa specifike shtesë, për të cilat çdo kandidat prezumohet se ka dhe duhet të ketë dijeni, që në momentin e shpalljes së interesit për t’u emëruar në një pozicion të skemës së shërbimit të jashtëm.

Për më tepër, duke ju referuar nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, rezulton se, konfirmimi në përfundim të periudhës së provës, bëhet nga eprori direkt, dispozitë e cila nuk gjen zbatim në rastin e nëpunësit civil në periudhë prove në Shërbimin e Jashtëm, pasi një procedurë e tillë finalizohet nga titullari i ministrisë.

Për shkak të specifikave që ka marrëdhënia në shërbimin e jashtëm, personeli diplomatik, teknik dhe administrativ në Shërbimin e Jashtëm duhet t’i nënshtrohen verifikimit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës, sipas përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 23/2015, *“Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”*, proces i cili shoqërohet me lëshimin e certifikatës së

sigurisë, nga autoriteti i ngarkuar me ligj, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Më tej, në referencë të Kreut IX, pika 4, të vendimit nr. 816, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, rezulton se këtë detyrim ligjor e kanë edhe kandidatët për t’u rekrutuar në shërbimin e jashtëm, para emërimit të tyre në këtë shërbim, konkretisht nëpunësit civilë në periudhë prove në shërbimin e jashtëm.

Sipas pikës 3, Kreut IX, të aktit nënligjor të mësipërm, mosmarrja e certifikatës së sigurisë dhe vërtetimit të pastërtisë së figurës së personelit diplomatik, teknik, administrativ dhe të shërbimit, përbën shkak për përjashtimin e punonjësit nga skema e Shërbimit të Jashtëm.

Në kushtet kur, ligji për nëpunësin civil zbatohet në Shërbimin e Jashtëm, për aq sa nuk vjen në kundërshtim me ligjin e posaçëm, arrihet në konkluzionin se mospajisja me certifikatën e sigurisë, përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së shërbimit civil në shërbimin e jashtëm. Me përjashtimin nga shërbimi i jashtëm, nëpunësi humbet automatikisht edhe të drejtat që gëzon në cilësinë e nëpunësit civil, fakt që nuk legjitimon pretendimin e tij për tu transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për të cilin nuk kërkohet pajisja me certifikatën e sigurisë.

Për më tepër, Komisioneri vlerëson të sjell në vëmendje se në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohen në mënyrë eksplicite rastet e aplikimit të institutit të transferimit të përhershëm. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 49, të këtij ligji, vërehet se nëpunësi civil caktohet detyrimisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastet:

- a) Gjendjes së paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozicionit të mëparshëm;
- b) E shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, sipas nenit 52 të këtij ligji
- c) Në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 56 të këtij ligji (*në përfundim të periudhës së pezullimit*).

Duke mbajtur parasysh sa më lart u arsyetua, Komisioneri arrin në konkluzionin se pretendimi i ankuesit *****, se njësia përgjegjëse (DAP) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, duhet të merrnin masa për transferimin ose sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për të cilin nuk kërkohet kriteri i pajisjes me certifikatë sigurie, është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 664 prot., datë 10.06.2021, të ankuesit ******, pasi rezultoi i pabazuar në ligj pretendimi për transferimin ose sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për të cilin nuk kërkohet detyrimi i pajisjes me certifikatën e sigurisë të lëshuar nga DSIK.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha